

VENDIMET E BORDIT TË FEDERATËS SË BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
30 maj 2026

Në mbështetje të kompetencave të Bordit të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), të përcaktuara me Statutin e FBK-së, përkatësisht nenin 24, si dhe në përputhje me Rregulloren e Punës së Bordit, Bordi i FBK-së, në mbledhjen e mbajtur më 30.05.2026, pas shqyrtimit dhe diskutimit të të gjitha pikave të rendit të ditës, merr këto vendime:

1. Pezullon mandatin e anëtarit të Bordit, z. Egzon Fetiu, për shkak të mos pjesëmarrjes në tri (3) ose më shumë mbledhje të Bordit, në përputhje me nenin 23, paragrafi 3 i Statutit. Ky vendim merret me qëllim të sigurimit të funksionimit efektiv të Bordit, respektimit të detyrimeve statutare të anëtarëve dhe garantimit të pjesëmarrjes aktive në proceset vendimmarrëse të organizatës. Çështja e shkarkimit të anëtarit do të procedohet për shqyrtim dhe vendimmarrje në Kuvendin e ardhshëm, në pajtim me Statutin.
2. Emëron Brahim Veselin si ndihmës trajner të Përfaqësueses A të Meshkujve, për shkak të angazhimeve të ndihmës trajnerit Andin Rashica edhe me përfaqësuesen U20 Meshkujt. Ky emërim bëhet me qëllim të sigurimit të funksionimit efikas të stafit profesional dhe garantimit të përgatitjeve dhe pjesëmarrjes së suksesshme të Përfaqësueses A të Meshkujve në aktivitetet dhe garat ndërkombëtare të parapara në kalendarin zyrtar të FIBA-s.

Në emër të Bordit të Federatës së Basketbollit të Kosovës

Arben **FETAHU**

Kryetar



Federata e Basketbollit të Kosovës

